



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО
UNIVERSITY OF TETOVO

№ 02-1755/2
21-06
Universiteti i Tetovës
Vjeprorshki Këshill i
Doktoratit Titullor i
Përfunduar me 10.06.2023
-06 1200, Tetovë, Republika

PROCESVERBAL

për realizimin e votimit për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës për mandatin 2023-2026

Pas marrjes së rezultateve për realizimin e votimit nga njësitë për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës, për mandatin 2023-2026, të dorëzuara nga komisionet individuale zgjedhore të njësive të Universitetit, komisioni universitar i zgjedhjeve ka kontrolluar dhe përmbledhur rezultatet e votimit për të gjitha njësitë në kuadër të Universitetit.

Më datë 21 qershor 2023, nga ora 12:00 deri në orën 14:00, u realizua votimi i fshehtë.

Në 13 fakultete në përbërje të Universitetit u votua për këto kandidatë për rektor:

1. **Bashkim Ziberi**, profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore,
2. **Dervish Alimi**, profesor ordinar në Fakultetin Filologjik,
3. **Jusuf Zejneli**, profesor ordinar në Fakultetin Juridik
4. **Myqereme Rusi**, profesor ordinar në Fakultetin Filozofik

Në të gjitha njësitë votimi filloi dhe përfundoi në orarin e caktuar.

Në bazë të raporteve dhe procesverbaleve të dorëzuara nga komisionet zgjedhore të njësive për zgjedhjet e mbajtura, vërtetohet se nuk janë konstatuar parregullsi dhe ndonjë problem tjetër, përkatësisht votimi është zhvilluar në tërësi në pajtim me Ligjin për arsimin e lartë, Statutin e Universitetit të Tetovës dhe Udhëzuesin për zgjedhjen e rektorit të Universitetit të Tetovës, për mandatin 2023-2026.

Gjatë votimit kanë qenë të pranishëm vëzhguesit e autorizuar të kandidatit për rektor, prof. dr. Jusuf Zejneli.

Bazuar në listat e zgjedhësve të njësive të Universitetit, janë regjistruar gjithsej 334 votues.

Në ditën e votimit për zgjedhjen e rektorit kanë votuar gjithsej 302 anëtarë të këshillave mësimore-shkencorë të njësive, respektivisht 90,42%.

Gjithsej fletëvotime të papërdorura mbetën 32 fletëvotime.

Rezultatet e votimit të shprehura në pikë të fituara nga secili kandidat për zgjedhjen e rektorit

Nr. rend	Njësia e UT-së (fakulteti/instituti)	Kandidati për rektor Prof. Dr Bashkim Ziberi Pikë të fituara	Kandidati për rektor Prof. Dr Dervish Alimi Pikë të fituara	Kandidati për rektor Prof. Dr Jusuf Zejneli Pikë të fituara	Kandidati për rektor Prof. Dr Myqereme Rusi Pikë të fituara
1.	Fakulteti Ekonomik	0	0	200	0
2.	Fakulteti Juridik	6,667	0	193,333	0
3.	Fakulteti Filozofik	8,696	0	191,304	0
4.	Fakulteti Filologjik	3,448	0	93,103	3,448
5.	Fakulteti Pedagogjik	10,526	0	189,474	0
6.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore	0	0	200	0
7.	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore	35	0	165	0
8.	Fakulteti i Shkencave të Zbatuara	0	0	200	0
9.	Fakulteti i Kulturës Fizike	0	0	200	0

10.	Fakulteti i Administratës së Biznesit	0	0	100	0
11.	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit	0	0	200	0
12.	Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë	0	0	200	0
13.	Fakulteti i Arteve	25	0	175	0

Nga rezultatet e bashkangjitura mund të konstatohet gjendja faktike si në vijim:

1. Kandidati për rektor, **Bashkim Ziberi**, profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, ka fituar gjithsej 89,337 pikë.
2. Kandidati për rektor, **Dervish Alimi**, profesor ordinar në Fakultetin Filologjik, ka fituar gjithsej 0 pikë.
3. Kandidati për rektor, **Jusuf Zejneli**, profesor ordinar në Fakultetin Juridik, ka fituar gjithsej 2307,215 pikë.
4. Kandidati për rektor, **Myqereme Rusi**, profesor ordinar në Fakultetin Filozofik, ka fituar gjithsej 3,448 pikë.

Në përputhje me nenin 106, paragrafi 9 i Statutit të Universitetit të Tetovës, për mandatin 2023-2026, rektor i Universitetit të Tetovës është zgjedhur kandidati:

Prof. Dr. Jusuf Zejneli, profesor ordinar në Fakultetin Juridik, i cili ka fituar më shumë pikë.

Vëzhgues i autorizuar i pranishëm Fatmir Tairi, për kandidatin për rektor prof. dr. Jusuf Zejneli.

Tetovë, më 21.06.2023

Kryetari i




komisionit universitar të zgjedhjeve

Prof. Dr. Nderim Zeqiri



(emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

Anëtarët e KUZ-së:

1. Flamure Ibraimi Sadiku – Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore 
2. Qenan Ferati – Fakulteti i Shkencave Mjekësore 
3. Zeqirja Idrizi – Fakulteti Filozofik 
4. Besa Dogani – Fakulteti Pedagogjik 
5. Milazim Kamberi – Fakulteti i Kulturës Fizike 
6. Metin Izeti – Fakulteti i Arteve 

(emri, mbiemri dhe nënshkrimi)